

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Raport Mujor Dhjetor 2017



Informacion bazë

Menaxhimi i Fondit	Raiffeisen INVEST
Monedha	LEK
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	1,000
Shuma minimale pasuese	1,000
Komision në hyrje	0%
Komision në dalje	0%
Penalite ne rast terheqje te parakohshme	Sipas rregullores se AMF-se
Komision Administrimi ne vit	1.50%
Kosto per transferte fondesh nga pale te treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit


Fondi i Pensionit Vullnetar është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata për vitet pas largimit përfundimtar nga puna. Ky fond zotërohet bashkërisht nga anëtarët e fondit dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest sh.a, në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit.

Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskut të marrë përsipër.

Fondi synon të ndërtojë një portofol të përbërë kryesisht nga letra me vlerë afatgjatë (me maturim më të lartë se një vit) të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Profili i Riskut të Investitorit

Risk i ulët Risk i lartë
Përfitimet tipike më të ulëta Përfitimet tipike më të larta




Fondi është në kategorinë e dytë të Profilit të Riskut.

Të dhëna për Fondin në 31.12.2017

Vlera Neto e Aseteve	506,975,269
Numri i investitoreve	2,800
Cmimi i Kuotes	1,634.9663
*Kthimi vjetor nga investimi (31.12.2016-31.12.2017)	5.86%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 31 Dhjetor 2017



Ne kuader te politikës se investimit te fondit te Pensionit, investimet do te kryhen kryesisht ne bono thesari dhe obligacione, te emetuara ne tregun primar te letrave me vlere, duke patur parasysh qe aktiviteti i tregtimit te letrave me vlere ne treg sekondar eshte shume i ulet.

Instrumenti

	Ne % te Aseteve te Fondit
<i>Obligacione Thesari</i>	98.22%
<i>Depozita / Llogari rrjedhese</i>	1.78

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here ne muaj; Obligacionet 2 vjeçare nje here ne muaj; Obligacionet 3, 5, 7 dhe 10 vjeçare jane me te rralla, afersisht nje here ne tre muaj.


Strategjia e investimeve nuk ka pesuar ndryshime dhe Fondi ka investuar ne obligacion 7 vjecar te Qeverise shqiptare gjate muajit Dhjetor. Vlera neto e asetëve te fondit ka tejkaluar LEK 506 milione ne date 31 Dhjetor 2017.

Ecuria e normave te interesit te letrave me vlere te Qeverise Shqiptare gjate muajit Dhjetor

Gjate muajit Dhjetor, normat e interesit te letrave me vlere vijuan trendin rrites te muajve te meparshem. Keshtu, yield-i mesatar i ponderuar i Bono Thesari 12 mujore u rrit me 9 pike baze krahasuar me Nentorin duke arritur nivelin e 2.633%.

Per sa u takon obligacioneve qeveritare, ankandet qe u zhvilluan gjate muajit Dhjetor ishin ato te obligacionit 2 dhe 7 vjecar. Norma e obligacionit 2-vjecar u rrit me 2 pike baze duke arritur ne nivelin 3.25%. Nderkohe, rritjen me te madhe e pesoi norma e interesit e obligacionit 7-vjecar, i cili u rrit me 51 pike baze dhe qendron aktualisht ne nivelin e 5.86%.

Grafiku me poshte jep nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bono thesari 12 muaj dhe obligacioneve 2, 5, 7 dhe 10 vjet te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjecare Dhjetor 2016 – Dhjetor 2017.




Ecuria e çmimit të kuotës deri në 31 Dhjetor 2017

Çmimi i kuotes se Fondit te Pensionit ka ndjekur nje trend rrites gjate vitit, megjithese se fundmi rritja ka qene me e ulet si rrjedhoje e nivelit te ulet te normave te interesit te obligacioneve afatgjata, gje qe ndikon negativisht ne kthimin nga investimi. Per pasoje, performanca ka rezultuar me e ulet krahasimisht me te njejtën periudhe vitin e kaluar, por mbetet gjithsesi e kenaqshme.


Kthimi vjetor neto i fondit eshte 5.86% per periudhen Dhjetor 2016 – Dhjetor 2017; megjithate duhet patur parasysh qe kthimi ndryshon ne varesi te kushteve te tregut. Kthimi mesatar vjetor neto qe nga momenti i lancimit te fondit ne 2010 deri ne 31 Dhjetor 2017 eshte 7.27%.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondit te Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Kthimi vjetor neto historik

Performanca vjetore e Fondit te Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Anetaret e fondit te Pensionit keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate qendrimi ne fond (mundesisht deri ne moshen e pensionit, pese vjet para moshes se percaktuar ne Ligj) per te perfituar nje kthim maksimal nga investimi, per te permiresuar standartin e jeteses ne moshen e pensionit dhe per te evituar penalitetet ne rast terheqje te parakohshme.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm janë të ftuar të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe bankieret e Raiffeisen Bank nuk garantojne nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sha, në web site www.raiffeisen-invest.al, ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.